

Komisioni i Pavarur i Kualifikimit jep vendimet për 66% të prokurorëve kandidatë në garë për ngritje në detyrë në Prokurorinë e Posaçme kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar

- *KPK ka konfirmuar në detyrë 10 nga 15 kandidatët në garë për prokurorë të posaçëm: Vendimet për 2 prej kandidatëve të konfirmuar janë apeluar në Kolegjin e Posaçëm të Apelimit*

Me përfundimin e procesit të intervistimit në 12 korrik 2019 dhe [miratimin e listës](#) me 15 kandidatët për prokurorë në Prokurorinë e Posaçme kundër korrupsionit dhe krimit të organizuar, Komisioni i Pavarur i Kualifikimit gjatë muajit korrik ka përshpejtuar zhvillimin e seancave dëgjimore dhe marrjen e vendimeve për këto kandidatë. Vendimet e KPK-së dhe Kolegjit të Posaçëm të Apelimit janë vendimtare për emërimin përfundimtar të 15 prokurorëve, të cilët konkurrojnë për 15 vendet vakante në Prokurorinë e Posaçme kundër korrupsionit dhe krimit të organizuar.

Aktualisht, gjatë kësaj periudhe KPK ka dhënë vendimet për 66% të prokurorëve të renditur nga Këshilli i Lartë i Prokurorisë për ngritje në detyrë në Prokurorinë e Posaçme. I rëndësishëm është fakti që Komisioni ka konfirmuar në detyrë të 10 prokurorët, të cilët janë paraqitur gjatë seancave dëgjimore. Deri tani asnjë nga prokurorët kandidatë për ngritje në detyrë në Prokurorinë e Posaçme, të cilët janë paraqitur përpara Komisionit nuk është shkarkuar, ndërkohë që për 5 kandidatët e tjerë vetting-u ende nuk ka përfunduar.

Megjithëse këto vendime në drejtim të konfirmimit të kandidatëve për prokurorë të posaçëm janë të rëndësishme për plotësimin e 15 vendeve vakante në Prokurorinë e Posaçme, duhet theksuar se rastet e apeluara dhe vendimet e Kolegjit të Posaçëm të Apelimit do të përcaktojnë në vazhdimësi ecurinë e këtij procesi. Deri tani nga 10 prokurorët e konfirmuar nga KPK, Institucioni i Komisionerëve Publikë ka ankimuar në Kolegjin e Posaçëm të Apelimit vendimet për 2 prej tyre, ndërkohë që për 5 prej tyre ka vendosur mosankimimin e vendimit të KPK-së. Sa i përket 3 prokurorëve të tjerë të konfirmuar

SPAK Info Nr. 11, përshkruan ecurinë e vetting-ut për kandidatët prokurorë dhe gjyqtarë në Prokurorinë dhe Gjykatat e Posaçme kundër korrupsionit dhe krimit të organizuar. Ky numër trajton gjithashtu edhe përmbushjen e disa apekteve financiare, logjistike dhe teknike me rëndësi për veprimtarinë normale të KLP dhe KLGJ.

Për shumë informacion mbi zbatimin e hapave ligjorë në drejtim të ngritjes së Gjykatave të Posaçme dhe SPAK mund të lexoni Buletinet 3-mujore SPAK Monitor të publikuara në faqen e CSDG: www.csdgalbania.org

Publikimet realizohen në kuadër të projektit “Monitorimi dhe vlerësimi i procesit të ngritjes dhe funksionimit të Gykatave të Posaçme kundër korrupsionit dhe krimit të organizuar dhe Strukturës së Posaçme SPAK, nëpërmjet hulumtimit, informimit, ndërgjegjësimit dhe mbështetjes në ngritjen e kapaciteteve administrative”, i mbështetur nga Fondacioni Shoqëria e Hapur për Shqipërinë.

së fundmi nga KPK, Institucioni i Komisionerëve Publikë do të vendosë gjatë periudhës në vijim brenda afateve të parashikuara ligjore.

Statusi i vetting-ut për kandidatët e renditur për prokurorë në Prokurorinë e Posaçme kundër Korrupsionit dhe Krimin të Organizuar				
		Vendimi i KPK	Vendimi i IKP	Vendimi i KPA
1.	Altin Dumani	Konfirmuar nga KPK		
2.	Anton Martini	Në proces rivlerësimi		
3.	Elizabeta Imeraj	Në proces rivlerësimi		
4.	Arben Kraja	Konfirmuar nga KPK	Vendimi i KPK i pa ankimuar	
5.	Doloreza Musabelliu	Në proces rivlerësimi		
6.	Klodian Braho	Konfirmuar nga KPK		
7.	Enkeleda Millonai	Konfirmuar nga KPK	Vendimi i KPK i pa ankimuar	
8.	Manjola Kajana	Konfirmuar nga KPK	Vendimi i KPK <i>ankimuar në KPA</i>	Në proces
9.	Edvin Kondili	Konfirmuar nga KPK	Vendimi i KPK i pa ankimuar	
10.	Ened Nakuçi	Konfirmuar nga KPK	Vendimi i KPK i pa ankimuar	
11.	Elida Kaçkini	Konfirmuar nga KPK		
12.	Ndini Tavani	Në proces rivlerësimi		
13.	Behar Dibra	Konfirmuar nga KPK	Vendimi i KPK i pa ankimuar	
14.	Anita Jella	Në proces rivlerësimi		
15.	Besnik Muçi	Konfirmuar nga KPK	Vendimi i KPK <i>ankimuar në KPA</i>	Në proces

* Burimi: Komisioni i Pavarur i Kualifikimit (www.kpk.al), Institucioni i Komisionerëve Publikë (www.ikp.al) dhe Kolegji i Posaçëm i Apelit (www.kpa.al)

Ritmet e procesit të rivlerësimit janë përsheptuar edhe në drejtim të gjyqtarëve të Gjykatave të Krimeve të Rënda, kandidatë për në Gjykatat e Posaçme kundër korrupsionit dhe krimin të organizuar. Thuajse të gjithë gjyqtarët e Gjykatës së Apelit për Krime të Rënda i janë nënshtruar tashmë këtij procesi (Tabela I – faqe 5). Ndërkohë, numri i ankimeve ka qenë i ulët. Me ritme më të ulta ka qenë procesi për gjyqtarët e Gjykatës së Shkallës së Parë për Krime të Rënda nga të cilët ende vetëm 1 gjyqtar nga 14 gjyqtarë që ka kjo Gjykatë i është nënshtruar vetting-ut (Tabela I).

Kolegji i Posaçëm i Apelit shkarkon anëtarin prokuror të Këshillit të Lartë të Prokurorisë: KLP vendos për mbarimin e mandatit të anëtarit të Këshillit, ndërkohë që Prokuroria e Përgjithshme pritet të hapë thirrjen për plotësimin e vendit vakant

- *Për të dytën herë brenda 7 muajsh Këshilli i Lartë i Prokurorisë mbetet me 10 anëtarë: Ndërkohë ende 2 anëtarë prokurorë të KLP-së presin vendimin e Kolegjit të Posaçëm të Apelit*

Vendimet e Kolegjit të Posaçëm të Apelit kanë rithyer gjendjen e funksionimit të Këshillit të Lartë të Prokurorisë me 10 anëtarë nga 11 që është numri i parashikuar për funksionimin e këtij institucioni. Ndryshe nga përvoja e Këshillit të Lartë Gjyqësor, KLP për herë të dytë ka [vendosur](#) në [seancën plenare nr. 25](#) mbarimin e mandatit të anëtarit prokuror të Këshillit Gentjan Osmani, si rezultat i vendimit të shkarkimit nga Kolegji i Posaçëm i Apelit në datën [31 korrik 2019](#). Prokurori Osmani u konfirmua nga

Komisioni i Pavarur i Kualifikimit në [gusht 2018](#), por vendimi i KPK-së u ankimua në Kolegjin e Posaçëm të Apelit gjatë muajit [nëntor 2018](#), rreth 1 muaj përpara zgjedhjes së anëtarëve dhe konstituimit të Këshillit të Lartë të Prokurorisë.

KLP pati një situatë të ngjashme edhe gjatë muajit mars 2019, me [shkarkimin](#) e anëtares prokurore Antoneta Sevdari. Prokuroria e Përgjithshme shpalli [thirrjen](#) për paraqitjen e shprehjes së interesit për kandidatë prokurorë në KLP, në faqen zyrtare të institucionit në të cilën u parashikuan kriteret dhe dorëzimi i dokumentacionit respektiv nga prokurorët nga Prokuroritë e Shkallës së Parë. Pas verifikimit për plotësimin e kushteve për anëtarë në Këshillin e Lartë të Prokurorisë, Prokuroria e Përgjithshme [njoftoi](#) mbi kandidaturën e vetme të prokurorit Vatë Staka (i [konfirmuar](#) në detyrë nga KPK në korrik 2018), i cili kandidoi për [herë të dytë](#) për pozicionin e anëtarit prokuror në KLP dhe i cili ishte [renditur](#) gjithashtu si një nga 27 kandidatët për të vazhduar garën për prokurorë në Prokurorinë e Posaçme. Prokuroria e Përgjithshme në vijim të zbatimit të procedurave të mëtejshme në lidhje me zgjedhjen e anëtarit të ri prokuror të Këshillit të Lartë të Prokurorisë, [miratoi](#) fleta tip e votimit për anëtarin prokuror të Këshillit të Lartë të Prokurorisë dhe referuar [njoftimit](#) përkatës të institucionit, në datën 11 prill 2019 zhvilloi Mbledhjen e Përgjithshme të Prokurorëve, e cila zgjodhi prokurorin Vatë Staka si anëtar prokuror të Këshillit të Lartë të Prokurorisë.

Ndërkohë që institucioni i Prokurorisë së Përgjithshme pritet të publikojë së shpejti thirrjen për plotësimin e vendit vakant në KLP duke ndjekur procedurat ligjore si më lart, duhet theksuar që ende për [2 anëtarë](#)¹ prokurorë të Këshillit të Lartë të Prokurorisë pritet të jepen vendimet e Kolegjit të Posaçëm të Apelit, duke përcaktuar në mënyrë përfundimtare anëtarësinë e tyre në organin kryesor të menaxhimit të sistemit të prokurorisë. Megjithëse, tashmë KLP ka përfunduar një nga proceset më të rëndësishme në funksion të ngritjes së Prokurorisë së Posaçme kundër korrupsionit dhe krimit të organizuar, siç ishte i gjithë procesi i shpalljes, shqyrtimit, vlerësimit, intervistimit dhe përzgjedhjes së kandidatëve për ngritje në detyrë në këtë organ, qëndrueshmëria e Këshillit mbetet një faktor kryesor për mbarvajtjen sistematike të punës. Pavarësisht se tashmë emërimi i prokurorëve të posaçëm pritet të kryhet vetëm pas vendimeve të KPK-së dhe KPA-së, Këshilli i Lartë i Prokurorisë do të vazhdojë të luajë një rol të rëndësishëm në ngritjen e organit kryesor të hetimit të veprave penale të korrupsionit dhe krimit të organizuar duke ushtruar kompetencat e parashikuara në legjislacion edhe pas krijimit të këtij institucioni.

Inagurimi i Pallatit të Ri të Drejtësisë finalizon problematikat e ambienteve të institucioneve të reja të drejtësisë: Këshilli i Lartë i Prokurorisë fillon procedurat për rekrutimin e stafit

- *Poli i Drejtësisë është godina e re e 4 institucioneve kryesore të drejtësisë: Rreth 7 muaj nga krijimi, Këshilli i Lartë i Prokurorisë fillon procedurat për rekrutimin e stafit*

Megjithëse, organet e reja të drejtësisë u konstituan në dhjetor të vitit 2018 një nga problematikat e lidhura me funksionimin e tyre ka qenë akomodimi i ambienteve të punës. Në mënyrë të veçantë, vështirësi në këtë drejtim ka patur Këshilli i Lartë i Prokurorisë, një organ i ri i parashikuar në kuadër të ndryshimeve kushtetuese, i cili e ka zhvilluar veprimtarinë e punës pjesërisht në ambientet e Prokurorisë së Përgjithshme dhe mbledhjet në zyrat e ish-Këshillit të Lartë të Drejtësisë (aktualisht Këshillit të Lartë Gjyqësor).

¹ Prokurorët anëtarë të KLP: Besnik Cani dhe Arben Dollapaj.

Pas diskutimit të disa [opsionesh dhe vështirësive](#), nëpërmjet një [vendimi](#) të muajit prill 2019, Këshilli i Ministrave ka vendosur për fillimin e procedurave për programin e integruar të zhvillimit të quajtur “Poli i Drejtësisë”. Nëpërmjet këtij programi ndër të tjera synohet zhvillimi i një zone urbane në funksion të krijimit të një blloku të integruar infrastrukture për akomodimin e institucioneve të qeverisjes së sistemit të drejtësisë si edhe të institucioneve të tjera të interesuara, me qëllim mbështetjen e këtyre institucioneve me infrastrukturën e nevojshme dhe bashkëkohore, në mënyrën më të shpejtë të mundshme.

Në këtë mënyrë, në godinën e cila është ndërtuar nga Dhoma Kombëtare e Avokatisë, e përcaktuar si pjesë integrale e zhvillimit të programit, me qëllim sigurimin e ambienteve/zyrave të punës dhe të përfaqësimit do të akomohen përveç Këshillit të Lartë të Prokurorisë edhe disa institucione të tjera duke përfshirë, Këshillin e Lartë Gjyqësor, Inspektorin e Lartë të Drejtësisë dhe Shkollën e Magjistraturës.

Pallati i ri i Drejtësisë, i quajtur ndryshe Poli i Drejtësisë u inaugurua në një ceremoni zyrtare të zhvilluar në 22 korrik 2019, 3 vjet nga miratimi i ndryshimeve kushtetuese, me pjesëmarrjen e përfaqësueve vendas dhe ndërkombëtarë, duke përfshirë të ngarkuarën me punë të SHBA-ve në Tiranë [Leyla Moses-Ones](#), shefen e ONM-s [Genoveva Ruiz Calavera](#), Ministren e Drejtësisë [Etilda Gjonaj](#) si dhe drejtuesit e [KLP](#), [KLGJ](#) dhe [Shkollës së Magjistraturës](#).

Ndërkohë, një nga problematikat e tjera të institucioneve të reja të drejtësisë ka qenë edhe alokimi i buxhetit dhe miratimi i strukturës organike. Në [26 shkurt të këtij viti](#), Kuvendi i Shqipërisë [miratoi me 72 vota pro dhe asnjë kundër strukturën](#) e Këshillit të Lartë të Prokurorisë dhe Këshillit të Lartë Gjyqësor, të cilat përbëhen respektivisht nga 65 dhe 125 persona. Pavarësisht mungesës financiare dhe njerëzore KLP duke filluar që nga muaji janar deri në korrik 2019 ka kryer dhe përfunduar disa nga kompetencat më të rëndësishme, siç kanë qenë procedurat në drejtim të përzgjedhjes së prokurorëve në Prokurorinë e Posaçme kundër korrupsionit dhe krimit të organizuar. Vetëm gjatë muajit qershor 2019 është alokuar buxheti për këtë institucion, ndërkohë që gjatë muajit gusht 2019, KLP ka publikuar në faqen zyrtare të institucionit vendet e para vakante, të cilat përfshijnë pozicione të rëndësishme në administratën e këtij organi. Përcaktimi përfundimtar i ambienteve të punës, alokimi i buxhetit si dhe rekrutimi i stafit të KLP-së konsiderohen faktorë të rëndësishëm për të mbështetur organizmin e veprimtarisë si një prej institucioneve të reja dhe më të rëndësishme në sistemin e drejtësisë.

Pozicioni	Drejtoria/Sektori/Njësia	Nr. i pozicioneve
Specialist i Administratë Protokollit	Drejtoria e Shërbimeve të Mirëmbajtjes	1
Specialistë të Dokumentimit të Seancave	Sektori i Shërbimeve Administrative në Drejtorinë e Shërbimeve të Mirëmbajtjes	2
Përgjegjës Sektori në Sektorin e Financës	Drejtoria Ekonomike dhe Burimeve Njerëzore, në Drejtorinë e Përgjithshme të Shërbimeve Mbështetëse në Këshillin e Lartë të Prokurorisë	-
Këshilltar	Njësia e Mbështetjes së Komisioneve në Departamentin e Shërbimeve Ligjore në Këshillin e Lartë të Prokurorisë	1
Këshilltarë	Njësia e Mbështetjes së Komisioneve në Departamentin e Shërbimeve Ligjore në Këshillin e Lartë të Prokurorisë	5
Specialistë të burimeve njerëzore	-	2
Specialistë	Sektori i Financës, në Drejtorinë Ekonomike dhe të Burimeve Njerëzore, në Drejtorinë e Përgjithshme të Shërbimeve Mbështetëse në Këshillin e Lartë të Prokurorisë	2
Specialist i IT-së	Sektori i Shërbimeve Administrative në Drejtorinë e Shërbimeve të Mirëmbajtjes	1

* Burimi: Këshilli i Lartë i Prokurorisë, <http://klp.all/category/vende-vakante/>

I. Statusi i procesit të rivlerësimit të Gjyqtarëve të Gjykatave të Krimeve të Rënda kandidatë për në Gjykatat e Posaçme KKKO

Gjyqtarët e Gjykatave të Krimeve të Rënda kandidatë për në Gjykatat e Posaçme KKKO			Statusi & Vendimi i KPK
Gjykata e Shkallës së Parë për Krime të Rënda			
1.	Sandër Simoni	Kryetar/Gjykata e Shkallës së Parë	Në proces rivlerësimi
2.	Ardit Mustafaj	Gjyqtar/Gjykata e Shkallës së Parë	Në proces rivlerësimi
3.	Irena Gjoka	Gjyqtare/Gjykata e Shkallës së Parë	Në proces rivlerësimi
4.	Daniela Shirka	Gjyqtare/Gjykata e Shkallës së Parë	Në proces rivlerësimi
5.	Etleva Deda	Gjyqtare/Gjykata e Shkallës së Parë	Në proces rivlerësimi
6.	Luan Hasneziri	Gjyqtar/Gjykata e Shkallës së Parë	Shkarkuar
7.	Flora Hajredinaj	Gjyqtare/Gjykata e Shkallës së Parë	Në proces rivlerësimi
8.	Fran Prendi	Gjyqtar/Gjykata e Shkallës së Parë	Në proces rivlerësimi
9.	Ilirjana Olldashi	Gjyqtare/Gjykata e Shkallës së Parë	Në proces rivlerësimi
10.	Liljana Baku	Gjyqtare/Gjykata e Shkallës së Parë	Në proces rivlerësimi
11.	Marsela Balili	Gjyqtare/Gjykata e Shkallës së Parë	Në proces rivlerësimi
12.	Bib Ndreca	Gjyqtar/Gjykata e Shkallës së Parë	Në proces rivlerësimi
13.	Miliana Muça	Gjyqtare/Gjykata e Shkallës së Parë	Në proces rivlerësimi
14.	Klodian Kurushi	Gjyqtar/Gjykata e Shkallës së Parë	Në proces rivlerësimi
Gjykata e Apelit për Krime të Rënda			
1.	Fehmi Petku	Kryetar/Gjykata e Apelit	Shkarkuar/Ankimuar në KPA
2.	Gjovalin Pernoca	Gjyqtar/Gjykata e Apelit	Në proces rivlerësimi
3.	Nertina Kosova	Gjyqtare/Gjykata e Apelit	Konfirmuar nga KPK dhe KPA
4.	Dhurata Haveri	Gjyqtare/Gjykata e Apelit	Në proces rivlerësimi
5.	Nure Dreni	Gjyqtare/Gjykata e Apelit	Në proces rivlerësimi
6.	Saida Dollani	Gjyqtare/Gjykata e Apelit	Konfirmuar
7.	Dhimitër Lara	Gjyqtar/Gjykata e Apelit	Konfirmuar
8.	Sokol Binaj	Gjyqtar/Gjykata e Apelit	Konfirmuar
9.	Gurali Brahimllari	Gjyqtar/Gjykata e Apelit	Shkarkuar
10.	Idriz Mulkurti	Gjyqtar/Gjykata e Apelit	Shkarkuar
11.	Albana Boksi	Gjyqtare/Gjykata e Apelit	Konfirmuar

* Statusi i rivlerësimit është përditësuar për herë të fundit në datën 13 gusht 2019

II. Statusi i procesit të rivlerësimit të prokurorëve kandidatë për në Prokurorinë e Posaçme KKKO

Kandidatët e renditur nga KLP për të vazhduar garën për prokurorë pranë Prokurorisë së Posaçme KKKO			Raportet për Analizimin e Aftësive Profesionale	Statusi & Vendimi i KPK*
1.	Altin Dumani	Prokuror/Prokuroria e Apelit Tiranë	Përfunduar/Miratuar nga KLP	Konfirmuar
2.	Anita Jella	Drejtuese/Prokuroria e Rrethit Gjyqësor Durrës	Përfunduar/Miratuar nga KLP	Në proces rivlerësimi
3.	Anton Martini	Prokuror/Prokuroria e Krimeve të Rënda	Përfunduar	Në proces rivlerësimi
4.	Arben Kraja	Prokuror/Prokuroria e Përgjithshme	Përfunduar	Konfirmuar
5.	Behar Dibra	Prokuror/Prokuroria e Krimeve të Rënda	Përfunduar/Miratuar nga KLP	Konfirmuar
6.	Besnik Muçi	Prokuror/Prokuroria e Krimeve të Rënda	Përfunduar	Konfirmuar/ANKIMUAR në KPA
7.	Doloreza Musabelliu	Prokurore/Prokuroria e Krimeve të Rënda	Përfunduar/Miratuar nga KLP	Në proces rivlerësimi
8.	Edvin Kondili	Prokuror/Prokuroria e Krimeve të Rënda	Përfunduar/Miratuar nga KLP	Konfirmuar
9.	Elida Kaçkini	Prokurore/Prokuroria e Rrethit Gjyqësor Tiranë	Përfunduar/Miratuar nga KLP	Konfirmuar
10.	Elizabeta Imeraj	Drejtuese/ Prokuroria e Rrethit Gjyqësor Tiranë	Përfunduar/Miratuar nga KLP	Në proces rivlerësimi
11.	Ened Nakuçi	Prokuror/Prokuroria e Krimeve të Rënda	Përfunduar/Miratuar nga KLP	Konfirmuar
12.	Enkeleda Millonai	Drejtuese/Prokuroria e Rrethit Gjyqësor Elbasan	Përfunduar/Miratuar nga KLP	Konfirmuar
13.	Klodian Braho	Prokuror/Prokuroria e Krimeve të Rënda	Përfunduar/Miratuar nga KLP	Konfirmuar
14.	Manjola Kajana	Prokuror/Prokuroria e Krimeve të Rënda	Përfunduar/Miratuar nga KLP	Konfirmuar/ANKIMUAR në KPA
15.	Ndini Tavani	Prokuror/Prokuroria e Rrethit Gjyqësor Tiranë	Përfunduar/Miratuar nga KLP	Në proces rivlerësimi
Kandidatët jashtë listës së KLP për të vazhduar garën për prokurorë pranë Prokurorisë së Posaçme KKKO				
1.	Besim Hajdarmataj	Prokuror/Prokuroria e Krimeve të Rënda	Përfunduar	Në proces rivlerësimi
2.	Donika Prela	Drejtuese/Prokurorisë së Shkallës së Parë për Krimet e Rënda	Përfunduar	Konfirmuar/ANKIMUAR në KPA
3.	Dorina Bejko	Prokurore/Prokuroria e Rrethit Gjyqësor Pogradec	Përfunduar/Miratuar nga KLP	Në proces rivlerësimi
4.	Dritan Prençi	Prokuror/Prokuroria e Krimeve të Rënda	Përfunduar	Konfirmuar
5.	Enkeleda Xhengo	Prokurore/Prokuroria e Rrethit Gjyqësor Durrës	Përfunduar/Miratuar nga KLP	Në proces rivlerësimi
6.	Maksim Sota	Prokuror/Prokuroria e Rrethit Gjyqësor Vlorë	Përfunduar/Miratuar nga KLP	Në proces rivlerësimi
7.	Vladimir Mara	Prokuror/Prokuroria e Krimeve të Rënda	Përfunduar/Miratuar nga KLP	Konfirmuar

* Statusi i rivlerësimit është përditësuar për herë të fundit në datën 13 gusht 2019